



**15**  
UNIVERSITETI  
**MESDHETAR**  
*vjet*  
**HISTORI SUKSESI**

**HONORIS**

**CAUSA**

**UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPERISË**



**HONORIS CAUSA**



# ISMAIL

## KADARE

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Akademik Ismail Kadare, me motivacionin: "Shkrimtari më i shquar shqiptar i shekullit XX, përfaqësuesi më i njohur i letërsisë shqipe në Botë, fenomen evropian i cilësisë intelektuale, promovues i vlerave më të larta etnodalluese shqiptare, protagonist i zhvillimeve më të rëndësishme intelektuale shqiptare, ballkanike dhe europiane".*

Ismail Kadare lindi në Gjirokastrë, më 28 janar 1936. Ai është akademik, politikan, aktivist dhe një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë. Nisi të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar, por kontributi i tij shtrihet edhe në dramaturgjji, poezi dhe përkthime. Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe nëpër botë. Kadare është shkrimtari i vetëm shqiptar me njohje ndërkombëtare të gjerësishme dhe është përkthyer në shumë gjuhë. Para Kadaresë, letërsia shqipe njihet pak në botë, dhe falë tij u bë e njohur, e lexuar dhe e çmuar. Për herë të parë në historinë e vet, nëpërmjet veprës së tij, letërsia shqipe përfaqësohet denjësisht në hartën e letërsisë botërore. Letërsia e Kadaresë ka dhënë një kontribut të çmuar edhe në krijimin e gjuhës dhe letërsisë kombëtare. Është laureat i shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 1992 u vlerësua me Prix Mondial Cino Del Duca. Në vitin 2005 fitoi çmimin "Man Booker Prize" i nominuar krahas nobelistëve Günter Grass, Garbiel Garcia Marquez, Kenzaburo Oe etj. Kryetari i jurisë e arsyetoi vendimin për t'i dhënë çmimin Kadaresë duke nënvizuar se: "Ismail Kadare është një shkrimtar që hedh në hartë një kulturë të tërë: historinë e saj, dëshirën, folklorin, politikën, fatkeqësitë, duke përfaqësuar kështu një shkrimtar universal me traditë rrëfimi që shkon deri tek Homeri". Në vitin 2009 u nderua me çmimin spanjoll "Princi i Asturias për Artet", çmimi më i rëndësishëm letrar në vendet spanjolle, dhe një nga çmimet letrare më prestigjioze në botë. Në vitin 2010 Ismail Kadare nderohet në Itali me çmimin Lericci Pea.

Në vitin 1996 Kadare u bë anëtar për jetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë. U bë anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe nga viti 2018 anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Malit të Zi. Akademik Ismail Kadare është dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Urdhrin "Nderi i Kombit" dhe nga shteti francez me urdhrat "Kryqi i Legjionit të Nderit" e "Oficer i Madh i Legjionit të Nderit".



# MICHAEL

# D. GRANOFF

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordoi titullin "Doctor Honoris Causa" Z. Michael D. Granoff, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në drejtimin me sukses të Fondit Amerikano-Shqiptar të Ndërmarrjeve, si iniciativë e Qeverisë amerikane për financimin dhe zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri dhe nxitjen e mbështetjen e ekonomisë shqiptare".*

Z. Michael D. Granoff është Kryetar i Fondit Amerikano-Shqiptar të Ndërmarrjeve që nga viti 1992 si dhe personalitet i shquar i ekonomisë dhe politikës amerikane. Z. Granoff është Themeluesi dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Pomona Capital, një kompani ndërkombëtare investimesh me kapital privat me rreth 8.5 miliardë dollarë nën menaxhim.. Është fitues i Urdhrit të Medaljes Skënderbej dhe Medaljes së Nënë Terezës nga Presidenti i Shqipërisë. Z. Granoff është anëtar i Këshillit të Marrëdhënieve me Jashtë ku shërben në Komitetin e Financës, drejtor i Grameen Bank US dhe Administrator i Fondacionit Hanadiv Rothschild. Z. Granoff mori një JD (Juris Doctor) nga Universiteti Georgetown dhe një BA nga Universiteti i Pensilvanisë.



# TEDROS ADHANOM

## GHEBREYESUS

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Dr. Tedros Adhanom Ghebreyesus, me motivacionin: "Për kontributin e shquar dhe përkushtimin për kujdesin shëndetësor universal, angazhimin profesional në përballimin e rreziqeve të shëndetit publik, koordinimin e përgjigjeve ndaj emergjencave shëndetësore në nivel global në dobi të shëndetit e mirëqenies së njeriut dhe për mbështetjen e asistencën për emergjencat mjekësore që i janë ofruar Shqipërisë në përballimin e pandemisë shkaktuar nga virusi Covid 19".*

Dr. Tedros Adhanom Ghebreyesus është Drejtor i Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, drejtues, studiues dhe kërkues i shquar në fushën e shëndetit publik global. Ai u bë Drejtori i parë i Përgjithshëm i OBSH-së i zgjedhur nga radhët e shumë kandidatëve nga Asambleja Botërore e Shëndetësisë dhe personi i parë nga Rajoni Afrikan i OBSH-së që drejton agjencinë kryesore të shëndetit publik në botë. Pasi mori detyrën si Drejtor i Përgjithshëm i OBSH-së në vitin 2017, Dr. Tedros filloi transformimin më të rëndësishëm në historinë e Organizatës, i cili ka gjeneruar një gamë të gjerë arritjesh duke u përballur dhe menaxhuar me sukses epideminë e virusit Ebola, pandeminë e virusit Covid-19 dhe shpërthimin e mpox. Para se të shërbente si Drejtor i Përgjithshëm i OBSH-së, ai mbajti dy poste të nivelit të lartë në qeverinë e Etiopisë si Ministër i Shëndetësisë nga 2005 deri në 2012 dhe si Ministër i Punëve të Jashtme nga 2012 deri në 2016. Si Ministër i Punëve të Jashtme nga 2012 në 2016, ai ngriti shëndetësinë si çështje politike në nivel kombëtar, rajonal dhe global. Dr. Tedros është autor i shumë botimeve shkencore në fushën e kërkimit për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëseu në nivel rajonal dhe në nivel global. Përgjatë karrierës së tij të gjatë kërkimore ai ka qenë anëtar i shumë iniciativave, bordeve dhe institucioneve prestigjioze të cilat veprojnë në fushën e shëndetësisë në rang botëror si dhe është nderuar me shumë çmime dhe vlerësime ndërkombëtare. Dr. Tedros u përfshi në 100 njerëzit më me ndikim të Time të vitit 2020.



# VAIRA

## VĪĶE-FREIBERGA

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Dr. Vike-Freiberga, me motivacionin: "Për kontribut të jashtëzakonshë dhe merita të veçanta në promovimin dhe mbështetjen globale të lidërshipt demokratik me qëllim parandalimin, zgjidhje së konfliktit dhe ruajtjes së paqes përmes ndërmjetësimit dhe promovimit të qeverisjes së mirë në formën e institucioneve demokratike, tregjeve të hapura, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës dhe promovimit të rolit të grave në lidërshiptin global".*

Dr. Vaira Vīķe-Freiberga, ish-Presidente e Republikës së Letonisë, drejtuese e shquar në rang global, studiuese dhe kërkuese në fushën e psikologjisë. Dr. Vaira Vīķe-Freiberga është Presidentja e parë grua e Letonisë për dy mandate nga viti 1999 deri në 2007. Në këtë periudhë ajo udhëhoqi me sukses Letoninë në proceset e integritimit në strukturat euroatlantike. Pasi shërbeu për dy mandate si Presidente e Letonisë, ajo u emërua e dërguar e posaçme për reformën e Kombeve të Bashkuara në 2005 dhe ishte kandidatë zyrtare për postin e Sekretares së Përgjithshme të OKB-së në vitin 2006. Në dhjetor 2007 ajo u emërua Zëvendëskryetare e grupit Reflektimi për të ardhmen afatgjatë të Evropës. Dr. Vike-Freiberga është anëtare, anëtare bordi ose patrone në 30 organizata ndërkombëtare, duke përfshirë World Leadership Alliance, Nizami Ganjavi International Centre, European Council on Foreign Relations si dhe pesë Akademi. Ajo është vlerësuar me 34 Urdhëra merite, 19 DhC, si dhe shumë medalje, çmime dhe nderime, për punë të dalluar në shkencat humane dhe shoqërore. Ajo ka botuar 14 libra dhe është autore e mbi 200 artikuj, kapituj librash, raporte dhe materiale audiovizive.



IVO

# JOSIPOVIĆ

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordoi titullin "Doctor Honoris Causa" Prof. Dr. Ivo Josipović me motivacionin: "Për kontribut të shquar në promovimin e bashkëpunimit, paqes e dialogut në rajon dhe ndërtimin e instrumentave të përbashkët në funksion të integritit të tij në BE".*

Prof. Dr. Ivo Josipović, ish-President i Republikës së Kroacisë, studiues e aktivist në fushën e shkencës, artit dhe politikës. Prof. Dr. Ivo Josipović ka qenë President i Republikës së Kroacisë nga viti 2010 deri në vitin 2015. I diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë dhe në Akademinë e Muzikës së Universitetit të Zagrebit, para zgjedhje së tij si President i Republikës ai ka qenë profesor në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Zagrebit, anëtar i Parlamentit të Kroacisë dhe anëtar i Këshillit Bashkiak të Zagrebit. Në të njëjtën kohë, Prof. Dr. Ivo Josipović ka qenë edhe kompozitor, Drejtor i Bienales Muzikore të Zagrebit: Festivali Ndërkombëtar i Muzikës Bashkëkohore si dhe Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës së Kompozitorëve të Kroacisë. Edhe pas zgjedhjes së tij si President i Republikës së Kroacisë, Prof. Dr. Ivo Josipović vijoi punën e tij si pedagog në Universitetin e Zagrebit dhe aktivitetin e tij si kompozitor. Gjatë presidencës së tij, Kroacia u bë anëtare e Bashkimit European. Në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Zagrebit, Prof. Dr. Ivo Josipović ka qenë profesor i Procedurës Penale dhe të Drejtës Penale Ndërkombëtare.



# THEODHOROS PANGALOS

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Prof. Dr. Theodoros Pangalos, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në zhvillimet e proceseve demokratike dhe perspektivën europiane të Greqisë, mbështjetjes për Shqipërinë në avancimin e proceseve demokratike dhe perspektivës së saj europiane dhe mbarëvajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit ndërmjet dy vendve dhe dy popujve tanë".*

Prof. Dr. Theodoros Pangalos, ishte një personalitet i shquar i politikës greke e asaj europiane, si dhe studiues e aktivist në fushën studimeve ekonomike. Ish Zëvendës Kryeministër i Qeverisë së Greqisë – Kryeministër Plotësues. Ish Ministër i Punëve të Jashtme, Ish Ministër i Transporteve&Komunikacionit, Ish Ministër Kulture. Ish Deputet i Attikës. Që prej vitit 1969 deri në 1978 punoi në Sorbonë si Profesor i Emëruar dhe Hulumtuam për çështje të zhvillimit ekonomik, të programimit dhe të planifikim-rregullim të territorit. Shërbeu gjithashtu si Drejtor i Institutit të Zhvillimit Ekonomik në të njëjtin Universitet. Në vitin 1981 u zgjodh për herë të parë deputet me partinë PASOK, dhe është rizgjedhur duke e ripërtërirë pa ndërprerje mandatin deri në vitin 2012. Në vitin 1982 shërbeu si Zëvendës Ministër Tregëtie, në vitin 1984 shërbeu si Zëvendës Ministër i Jashtëm për Çështje të Komunitetit Europian dhe në periudhën 1985 – 1989 shërbeu në postin e Ministrit Plotësues të Punëve të Jashtme. Më datë 6 Tetor 2009 u betua si Zëvendës Kryeministër. Ushtroi këtë funksion deri në muajin Maj 2012.





# DRITAN

# ABAZOVIC

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Dr. Dritan Abazovic, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në promovimin e bashkëjetesës dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Republikën e Malit të Zi, promovimin e multikulturalizmit dhe ndërtimin e instrumentave të përbashkët për zhvillimin dhe ruajtjen e paqes e dialogut në rajon, në funksion të integritetit të tij në Bashkimin Europian".*

Dr. Dritan Abazovic është ish-Kryeministri i Malit të Zi dhe i pari Kryeministër i kombësisë shqiptare, politikan, studiues dhe aktivist në fushën e politikës. Para se të betohet si Kryeministër i Malit të Zi, ai ka shërbyer si Zëvendëskryeministër Ministër 2020–2022. Në vitin 2012 ishte deputeti më i ri në Parlament dhe shërbeu si deputet deri në vitin 2020, kur u emërua në një detyrë të re. Z. Dritan Abazovic është doktor i shkencave politike. Ai është autor i dy librave: "Kultura kozmopolitane dhe drejtësia globale" dhe "Kritika e etikës globale". Mori titullin politolog në një kohë rekord, duke përfunduar një fakultet katërvjeçar në vetëm dy vjet e shtatë muaj. Ai ishte nxënësi më i mirë i brezit, dhe fituesi i Distinktivit të Artë dhe Kartës së Artë të Universitetit të Sarajevës. Ai u regjistrua në studimet master në 2007, në Universitetin e Malit të Zi, drejtimi Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike.





# FELIX

# UNGER

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Prof. Dr. Felix Unger, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në krijimin dhe zhvillimin e hapësirës së përbashkët evropiane të shkencës dhe ngritjen e drejtimit e institucioneve të rëndësishme në funksion të saj".*

Prof. Dr. Felix Unger, themelues dhe President i European Academy of Sciences and Arts për tre dekada është personalitet i shquar në fushën e kardiokirurgjisë dhe mjekësisë botërore. Në vitin 1990 ai themeloi Akademinë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, së bashku me Kardinal König dhe Profesor Lobkowitz. Nga viti 1985 deri në vitin 2011 ka qenë drejtues i Klinikës Universitare për Kardiokirurgji në Salzburg. Prej vitit 2001 është president i Institutit Evropian të Shëndetësisë. Prof. Unger është anëtar i një sërë akademish të shkencës: anëtar korrespondues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shtetit Federal Gjerman të Nordrhein-Westfalisë, Letonisë, Sllovenisë dhe Serbisë; anëtar i rregullt i Leopoldina Gjermane, Sllovaki dhe Akademisë së Shkencave të Nju Jorkut; anëtar i asociuar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi.



# ANDREAS GROSS

*UUniversiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordoi titullin "Doctor Honoris Causa" Prof. Dr. Andreas Gross me motivacionin: Për kontribut të shquar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në mbështetjen dhe zhvillimin e proceseve demokratizuese për ridimensionimin e shoqërive post totalitare në Europë".*

Prof. Dr. Andreas Gross, ish-Kryetar i Grupit Parlamentar Socialist në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, një personalitet i shquar i politikës europiane dhe studiues e aktivist në fushën e filozofisë dhe çështjeve të demokracisë. Ai është Anëtar i Këshillit Kombëtar të Zvicrës dhe përfaqësues i Zvicrës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Që nga viti 1995, Andreas Gross ka qenë gjithashtu një nga përfaqësuesit e Zvicrës në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Në këtë funksion ai shkroi një raport të gjerë kundër diskriminimit dhe nevojës për përmirësim të situatës së pakicave seksuale në Evropë. Përveç kësaj, ai është një ekspert i thellë i vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik ku ai ka shërbyer vazhdimisht si vëzhgues i zgjedhjeve. Ai ka paraqitur disa raporte në Këshillin Evropian për situatën në Rusi dhe Ukrainë.



# ABDULAZIZ SAUD

## AL-BABTAIN

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordoi titullin "Doctor Honoris Causa" Z. Abdulaziz Saud Al-Babtain me motivacionin: "Për kontribut të shquar në promovimin e kulturës së paqes në bashkësinë ndërkombëtare, ndërtimin e instrumenteve të përbashkëta të bashkëpunimit nëpërmjet përhapjes së kulturës, edukimit dhe dialogut për sigurinë e brezave të ardhshëm".*

Z. Abdulaziz Saud Al-Babtain është themelues, drejtues dhe Kryetar i Bordit të Administrimit të Fondacionit Kulturor "Abdulaziz Saud Al Babtain" dhe President i Këshillit të Anëtarëve të Fondacionit Kulturor "Abdulaziz Saud Al Babtain" në Bashkimin Evropian. Z. Abdulaziz Saud Al-Babtain është poet e aktivist në fushën e shkencës, artit dhe politikës ndërkombëtare, por edhe atë të sipërmarrjes. Ai është një zë i fuqishëm nga bota arabe i cili nëpërmjet aktivitetit të tij të spikatur civil, punon për të krijuar një komunitet ndërkombëtar të angazhuar në arritjen dhe ruajtjen e paqes në botë dhe forcimit të dialogut. Ai ka botuar 3 vëllime më poezi, "Intimations of the Desert" në 1995; "Wastefarer" në 2004 dhe "The Songs of the Deserts" në vitin 2017. Po në këtë vit, z. Abdulaziz Al-Babtain botoi edhe librin, "Contemplations for Peace", i cili është një thirrje për mbarë njerëzimin për të përqafuar paqen si vlerë, synim dhe mënyrë jetese. Forumi Botëror për Kulturën e Paqes, i organizuar çdo vit nga Fondacioni Kulturor "Abdulaziz Saud Al Babtain", mbledh së bashku liderë, zyrtarë të nivelit të lartë nga qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare, akademike dhe anëtarë të shoqërisë civile për të diskutuar mbi kulturën e paqes në arsim dhe mbrojtjen e njerëzimit.



# GIANNI PITTELLA

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordoi titullin "Doctor Honoris Causa" Dr. Gianni Pittella, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në nxitjen dhe mbështetjen e proceseve integruese Euro-Atlantike të Shqipërisë".*

Dr. Gianni Pittella është një personalitet i shquar i politikës evropiane dhe studiues i mprehtë i çështjeve dhe politikave Euro-Mesdhetare. Në vitin 1996 u zgjodh deputet në Parlamentin italian. Pasioni i tij për Evropën e bëri atë të vazhdojë angazhimin e tij politik në nivel të BE-së dhe në vitin 1999 ai u zgjodh në Parlamentin Evropian, ku u bashkua me Grupin e Partisë Socialiste Evropiane (emri i mëparshëm i Grupit S&D). Për 19 vjet, nga viti 1999 deri në vitin 2018, z. Pittella ishte deputet i Parlamentit Evropian. Vitet e fundit, ai ka mbajtur role të ndryshme të rëndësishme brenda Grupit S&D si kryetar i delegacionit italian (që nga viti 2006) dhe nënkryetar i parë i Parlamentit Evropian (2009-2014). Si nënkryetar, përveç përgjegjësi të tjera, ai u mor me procedurat e pajtimit ndërmjet Parlamentit dhe Këshillit Evropian. Ai u bë president i përkohshëm i Parlamentit Evropian në qershor 2014. Më 2 korrik 2014, ai u zgjodh president i Grupit S&D, grupi i dytë politik në Parlamentin Evropian për nga numri i deputetëve dhe i vetmi grup që kishte anëtarë nga të 28 vendet e BE-së.



# ARISTOTEL

## PANO

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Prof. Dr. Aristotel Pano, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në veprimtarinë shkencore dhe pedagogjike në fushën e financave dhe ekonomisë në Shqipëri dhe rol të spikatur në përhapjen e dijes".*

Prof. Dr. Aristotel Pano, ka qenë një nga studiuesit më të spikatur e aktivist në fushën e studimeve ekonomike në Shqipëri. Ai mbaroi me medalje të artë Teknikumin Financiar në Tiranë dhe në vitin 1955 u diplomua me rezultate të shkëlqyera në Institutin e Lartë Financiar të Moskës. Pas diplomimit punoi si specialist në Ministrinë e Financave dhe në vitet 1956-1980 ishte pedagog pranë Fakultetit Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tiranës. Në 1987 i jepet titulli "Profesor". Gjatë viteve 1955-2019 ka bashkëpunuar me institute studimore brenda dhe jashtë vendit dhe ka botuar mbi 30 libra dhe monografi si dhe mbi 40 studime dhe artikuj shkencorë për analizën ekonomiko-financiare, kontabilitetin, financat dhe shkencën ekonomike në përgjithësi. Në vitin 1984, për një nga punimet e tij mbi të ardhurat kombëtare të Shqipërisë, u nderua me çmimin e "Republikës të Shkallës së Dytë". Është dekoruar me urdhërin "Naim Frashëri" të shkallës I-rë e të II-të dhe me medaljen "Nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë". Në vitin 2009 Shoqata e Kontabilistëve dhe i Financierëve të Shqipërisë i akordoi titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës". Zotëronte disa gjuhë të huaja.



# URICCHIO ANTONIO

## FELICE

*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i akordon titullin "Doctor Honoris Causa" Prof. Dr. Uricchio Antonio Felice, me motivacionin: "Për kontribut të shquar në nxitjen e bashkëpunimit ndëruniversitar për zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë dhe ndërtimin e instrumentave të përbashkët në funksion të këtij bashkëpunimi".*

Prof. Dr. Uricchio Antonio Felice, ish-Rektor i Universitetit "Aldo Moro" të Barit, studiues e aktivist në fushën e studimeve të së drejtës dhe financave publike. Aktiviteti shkencor dhe didaktik i Prof. Dr. Uricchio Antonio Felice është intensiv. Ai është autor i 7 monografive, është përkujdesur për botimin e 20 përmbledhjesh dhe mbi 200 artikuj në revista shkencore mbi financat publike, ligjin e taksave, politikat mjedisore dhe profilet ligjore e novacionit teknologjik. Koordinator i kursit të Administratës Publike në ekonomi dhe financa (Qeverisja e mjedisit dhe territorit) të Shkollës Doktorale në Drejtësi (Ish - Koordinator e Doktoratës së hulumtim në Administratën Publike të Ekonomisë dhe Financave). Në të njëjtin Universitet ai ishte Presidenti i Komisioni i Patentave, Koordinator i Observatorit gjenerator, Koordinator i Komitetit të Politikave mjedisore. Ai ishte gjithashtu anëtar i Komisioneve të Ndërkombëtarizimit dhe Programit të Diplomimit Master. Ai është gjithashtu pjesë e Komitetit të Buxhetit dhe Komisionit për departamentet dhe qendrat shkencore.





**HONORIS CAUSA**

15  
UNIVERSITETI  
MESDHEJAR  
15  
vjet  
HISTORI SUKSESI

# HONORIS CAUSA

UNIVERSITETI MESDHEJAR I SHQIPERISË